



Water and Waste Regulatory Office
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturin
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad

UNMIK



ZRRUM – R 05 / W&WW

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA (“ZRRUM”)

RREGULL

PËR SHKYÇJEN E SHËRBIMEVE TË UJIT

NGA

**OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË
KOSOVË**

26 Janar 2005

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull.....	4
Neni 2: Përfshirja	4
Neni 3: Qëllimi.....	4
Neni 4: Definicionet.....	4
Neni 5: Rregullat e Interpretimit.....	8
Neni 6: Aplikueshmëria	8
PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME	8
Neni 7: Parimet e Përgjithshme.....	8
Neni 8: Hetimi i bërë para se të zbatohet Shkyçja	9
Neni 9: Ekzekutimi i Shkyçjes.....	9
PJESA III: PROCEDURAT E SHKYÇJES	10
Kapitulli 1: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit	10
Neni 10: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit.....	10
Neni 11: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit në Objektin Tjetër	10
Kapitulli 2: Shkyçja për shkak të Rreziqeve Shëndetësore dhe të Sigurisë	10
Neni 12: Shkyçja për shkak të Rreziqeve Shëndetësore dhe të Sigurisë	10
Neni 13: Procedurat për Shkyçje për Shkaqe të Shëndetit ose të Sigurisë	11
Kapitulli 3: Shkyçja për Shkak të Rrjedhjes në Objektet e Konsumatorit	11
Neni 14: Rrjedhje të Dukshme, të Jashtme në Objektet e Konsumatorit.....	11
Neni 15: Procedurat e Shkyçjes për Rrjedhjet në Objektet e Konsumatorit.....	11
Kapitulli 4: Objektet e Braktisura	13
Neni 16: Shkyçja për Shkak të Braktisjes	13
Kapitulli 5: Shkyçjet që Kërkojnë Njoftimin për Shkyçje	13
Neni 17: Njoftimi për Shkyçje	13
Neni 18: Përbajtja e Njoftimit për Shkyçje.....	14
Neni 19: Procedurat e Njoftimit për Shkyçje për Prona të Dhëna ose të Marrura me Qira.....	14
Neni 20: Kompensimi	16
PJESA IV: SHKYÇJET KOLEKTIVE	16
Neni 21: Rrethanat për Shkyçje Kolektive.....	16
Neni 22: Leja nga Rregullatori për Shkyçje Kolektive.....	17
Neni 23: Ekzekutimi i Shkyçjes Kolektive	18
Neni 24: Pagesa e Rikyçjes për Shkyçje Kolektive	18
Neni 25: Kompensimi për Dëmet e shkaktuara nga Shkyçja Kolektive.....	18
Neni 26: Kompensimi për Konsumatorët në Pozitë të Mirë.....	19
PJESA V: RIKYÇJET DHE DEPOZITET PËR GARANCI	19
Kapitulli 6: Rikyçjet e Shërbimeve të Ujit	19
Neni 27: Rikyçja nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit	19
Neni 28: Refuzimi për të Rikyçur	19
Neni 29: Rikyçjet e Paligjshme.....	20
Neni 30: Konfiskimi i Pajisjes për Shërbime të Ujit.....	20
Kapitulli 7: Depoziti Garantues	21
Neni 31: Depoziti Garantues.....	21

PJESA VI: MARRËVESHJET PËR PAGESË	21
Neni 32: Marrëveshjet për Pagesë.....	21
Neni 33: Kontestimet e Besueshme të Faturave	23
Neni 34: Pagesat për Njoftimet e Shkyçjes, Shkyçje, dhe Rikyçje.....	23
PJESA VII: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT	24
Kapitulli 8: Zbatimi i Rregullit për Shkyçje	24
Neni 35: Zbatimi i Rregullit për Shkyçje.....	24
Kapitulli 9: Shënimet dhe Raportet mbi Shkyçjet	24
Neni 36: Shënimet dhe Raportet mbi Shkyçjet.....	24
Kapitulli 10: Kundërvajtjet dhe Dënimet	24
Neni 37: Kundërvajtjet dhe Dënimet	24
Kapitulli 11: Ankesat	Error! Bookmark not defined.
Neni 38: Ankesat.....	Error! Bookmark not defined.
PJESA VIII: TË NDRYSHME	Error! Bookmark not defined.
Neni 39: Gjuhët Zyrtare të Rregullit	Error! Bookmark not defined.
Neni 40: Hyrja në Fuqi.....	Error! Bookmark not defined.
SHTOJCAT	26
SHTOJCA 1	27
PAGESAT PËR NJOFTIMET PËR SHKYÇJE, SHKYÇJET, DHE RIKYÇJET	27
SHTOJCA 2	28
MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS	28

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori lëshon këtë Rregull duke u mbështetur në autorizimet e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë.

Neni 2: Përfshirja

Kjo Rregull do të administrojë me Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit dhe me Marrëveshjet për Pagesë nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Kosovë.

Neni 3: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është të ofrojë kushtet, konditat dhe procedurat për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit dhe të lidhin Marrëveshjet për Pagesë me Konsumatorët për të lehtësuar pagesën për Shërbimet e marrura të Ujit.

Neni 4: Definicionet

AKM nënkupton Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit;

Ditë Pune nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

Borxhi i Vjetër nënkupton borxhin e Konsumatorit të evidentuar nga faturat e papaguara të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve tek ai Konsumator më ose para 31 dhjetorit 2002. i cili nuk është paguar në tërësi si i definuar dhe i rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar dhe/ose të plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Konsumator nënkupton çdo person që ka lidhë Kontratën për Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza apo kontratën për Furnizim me Ujë me Shumicë që në mënyrë të ligjshme ka marrë Shërbime për Ujë të furnizuara nga Ofruesi i Shërbimeve;

- i. Konsumator Shtëpiak** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- ii. Konsumatori Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumatori i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- iii. Konsumator Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.

Konsumatori në Pozitë të Mirë nënkupton Konsumatorin i cili nuk ka Llogari të Papaguar por është shkyçur pa dashje ose si pjesë e Shkyçjeve Kolektive;

Karta e Konsumatorëve nënkupton dokumentin e shkruar, të përgatitur nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që i bëhet me dije secilit Konsumator në të cilin paraqiten të drejtat dhe obligimet e Ofruese të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Konsumatorëve ndaj njëri tjetrit;

Komisioni Konsultativ i Konsumatorëve nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori për secilën Zonë të Shërbimeve për të hulumtuar dhe zgjidhur Ankesat e Konsumatorëve dhe të drejtojtë anketat lidhur me Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Gypi i Kyçjes së Konsumatorit nënkupton gypin nga gypi kryesor shpërndarës i Ofruesit të Shërbimeve deri te objekti i Konsumatorit i cili përbëhet prej dy pjesëve:

- i. **Gypi Komunikues** nënkupton gypin që bën lidhjen nga gypi kryesor shpërndarës tek linja e pronës së Lokalit të Konsumatorit dhe është përgjegjësi e Ofruesit të Shërbimeve;
- ii. **Gypi i Furnizimit** nënkupton gypin prej linjës së pronës së Lokalit të Konsumatorit tek objektet e Konsumatorit dhe është përgjegjësi e Konsumatorit;

Llogaria e Papaguar nënkupton llogarinë në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i cili nuk është rregulluar nga Konsumatori gjatë orarit të rregullt të punës, ku Konsumatori ka marrë faturën për pagesë dhe kohën e mjaftueshme për të paguar;

Lokali nënkupton lokacionin në të cilin bëhet apo ofrohet Shërbimi për Ujë dhe/ose Shërbimi për Ujëra të Zeza;

Kontestimi i Besueshëm i Faturës nënkupton kontestimin lidhur me Faturën e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që është inicuar me shkrim nga Konsumatori para se asaj Fature t'i kalojë afati për pagesë duke u siguruar se shuma totale e pagueshme nuk është më pak se njëzet përqind (20)% më e madhe se mesatarja sezonale e konsumit të paguar nga ai Konsumator gjatë periudhës paraprake dymbëdhjetë (12) muajshe dhe nëse ai kontestim nuk është i paarsyeshëm ose shqetësues;

Pozitë e Mirë nënkupton, në lidhje me Konsumatorin e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i cili:

- i. ka paguar Faturat e tij të pakontestueshme brenda njëzetekatër (24) ditëve nga data kur ajo Faturë është e caktuar për t'u paguar; ose
- ii. ka lidhë, dhe i përmbahet Marrëveshjes për Pagesë me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Depoziti për Garanci nënkupton pagesën avansit në të holla për Shërbimet e ardhshme të Ujit ë të cilat mirren me kredit;

Faturë nënkupton njoftimin me shkrim për të paguar për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza, qe saktëson shumën e borxhit që është e pagueshme, dhe periudhën për të cilën janë ofruar shërbimet, të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza tek Konsumatori në gjuhën Shqipe dhe Serbe;

Grupi i Kualifikuar nënkupton grupin e Konsumatorëve në zonën specifike gjeografike, të cilët kanë kyçjen e përbashkët ose një shpërndarëse të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, prej të cilëve së paku pesëdhjetenjë përqind (51%) nuk janë në Pozitë të

Mirë;

Kyçje e Ligjshme nënkupton:

- i. ndërlidhjen në mes të objekteve të Konsumatorit që është në Regjistrin e Konsumatorëve dhe rrjetit shpërndarës për Shërbime të Ujit të kryer nga ai Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza; ose
 - ii. ndërlidhjen në mes të objektit të Personit dhe rrjetit shpërndarës të krijuar nga Ofruesit përkatës i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose paraardhësve të tij sipas ligjit të aplikueshëm,
- dhe "I Kyçur Ligjshëm" do të ketë kuptimin e njëjtë.

Njoftimi për Rrjedhje nënkupton njoftimin që i bëhet Konsumatorit nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për rrjedhjet e dukshme në pronën e Konsumatorit;

Kontrata e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nënkupton kontratën standarde e cila duhet të lidhet në mes të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Konsumatorit që rregullon ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Shërbimeve të Ujërave të Zeza dhe të drejtat dhe obligimet e palëve ndaj asaj kontrate të krijuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve në fjalë, ose, në mungesë të asaj kontrate me shkrim, dispozitat dhe kushtet standarde të furnizimit me Shërbime të Ujit të cilat bëhen nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit ndaj Konsumatorëve të vet;

Konsumatori që Nuk Pagan nënkupton cilindo Konsumator i cili ka mbetur njëzetekatër (24) ditë ose më shumë pa paguar lidhur me Faturën të Ujit dhe Ujërave të Zeza, megjithatë, llojet në vijim të Konsumatorëve nuk do të klasifikohen si Konsumatorë që Nuk Paguajnë:

- (i) Konsumatori që nuk ka pranuar fizikisht Faturën nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza; dhe
- (ii) Konsumatori i cili nuk e marrë Faturën e vet në ndonjërin nga gjuhët Shqipe, Serbe dhe Angleze;

Kyçje e Paligjshme nënkupton lidhjen në mes pronës së Konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të Shërbimeve të Ujit të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që nuk është krijuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose paraardhësit e tij sipas ligjit të aplikueshëm, dhe "i Kyçur Paligjshëm" do të ketë kuptimin e njëjtë;

Marrëveshja e Pagesës nënkupton marrëveshjen për të paguar Borxhet e Vjetra të lidhur në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, të definuar dhe rregulluar sipas Rregullës së caktuar mbi Borxhet e Vjetra të lëshuar, ndryshuar dhe/ose të plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Mbyll nënkupton ndërprerjen e furnizimit të ujit tek konsumatori pa e prerë apo dredhur në mënyrë fizike cilëndo pjesë të Gypit të Kyçjes së Konsumatorit;

Person i Cenueshëm nënkupton

Person nënkupton një individ, subjekt legal apo publik përfshirë korporatë, ortakëri, trust, organizatën jokorporuese, një qeveri apo cilëndo agjenci apo nënsektor të saj;

I Penguar Fizikisht nënkupton hyrjen e ndaluar me anë të forcës fizike apo me kërcënim fizik, duke u siguruar, megjithatë, se I Penguar Fizikisht nuk do të përfshijë pamundësinë e lexuesit të ujëmatësve për të pasë qasje si rezultat i veprimit natyror.

Regjistri i Konsumatorëve nënkupton regjistrin e Konsumatorëve të krijuar dhe të mbajtur

nga Ofruesi i Shërbimeve;

Rregullatori nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;

Shkycje nënkupton ndërprerjen e ndërlidhjes në mes të objektit të Konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për Shërbime të Ujit e cila ndërlidhje i mundëson Konsumatorit të marrë ato Shërbime nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe "Shkyc" do të ketë kuptimin e njëjtë;

Shkycje Kolektive nënkupton shkycjen e njëkohshme të Grupit të Kualifikuar, dhe "Shkyc në mënyrë Kolektive" do të ketë kuptimin e njëjtë;

Shpallje Publike nënkupton një njoftim në gjuhën Angleze, Shqipe dhe Serbe që ka të bëjë me Shkycjet Kolektive të propozuara që publikohet në formën e parashkruar nga Rregullatori qoftë në mediat regjionale ose nacionale ose një njoftim arsyeshëm i kalkuluar për të arritur tek Grupi i Kualifikuar;

Standardi i Shërbimeve nënkupton vlerën numerike të parametrave të operimeve apo mirëmbajtjes të paraqitur në nivelin që siguron kualitetin, sigurinë dhe besueshmërinë e: (a) furnizimit me sistem gypor të ujit për Konsumatorët dhe operimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujit, ose (b) grumbullimin e ujërave të zeza nga Konsumatorët dhe operimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Grumbullimit të Ujërave të Zeza;

- i. cilindo Person natyral të çertifikuar nga mjeku i licencuar që mund të i rrezikohet jeta apo shëndeti pa Shërbime për Ujë;
- ii. Cilido Konsumatori i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor, dhe që i këshillohet Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza si një që ka të drejtë që fatura e tij të paguhet nga autoritetet kompetente të mirëqenies sociale.

Sistemi i Grumbullimit të Ujërave të Zeza nënkupton të gjitha asetet e shfrytëzuara për dhe/ose në lidhje me ofrimin dhe/ose marrjen e Shërbimeve të Ujërave të Zeza qoftë atyre që i përkasin domenit publik ose të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Shërbimet e Ujërave të Zeza nënkupton mbledhjen, zbrazjen dhe përpunimin e ujërave të zeza dhe kanalizimit;

Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nënkupton Personin që ofron apo që mendon të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Rrjeti i Ujit nënkupton të gjitha asetet e shfrytëzuara për dhe/ose në lidhje me ofrimin dhe/ose marrjen e Shërbimeve të Ujit qoftë atyre që i përkasin domenit publik ose Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

Shërbimet e Ujit nënkupton nxjerrjen, përpunimin, dhe shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor dhe operimin e rrjetit dhe objekteve për atë qëllim; dhe

Paisjet e Shërbimeve të Ujit nënkupton gypat, valvulet, ujëmatësit, dhe gjërat tjera të Gypit të Kycjes të cilat janë pronë e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.

Vërejtja për Shkycje nënkupton njoftimin të cilin Ofruesi i Shërbimeve e jep para se të

ndodhë shkyçja;

Zona e Shërbimit nënkupton, në lidhje me Licencën e Shërbimit, Regjionin apo Komunën brenda të cilit Ofruesi Përkatës i Shërbimit mund të ofrojë shërbimet e tij;

Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, të cilat nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Hyrjen e kësaj Rregulle dhe/ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilitdo Rregull të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët që përdoren në cilëndo gjini do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe

Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse qëllimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të kësaj Rregulle.

Neni 6: Aplikueshmëria

Nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza kërkohet që të bien në pajtim me këtë Rregull.

PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 7: Parimet e Përgjithshme

- 7.1 Shkyçja është e kufizuar vetëm për Shërbimet e Ujit.
- 7.2 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të bëjë dallime të paligjshme ndaj asnjë Personi për çfarëdo arsye që ka të bëjë me Shkyçjen dhe do të merr në konsiderim vështirësitë që paraqiten për shkak të Shkyçjes.
- 7.3 Vërejtja për Shkyçje duhet të shpallet ose do të dërgohet jo më vonë se dhjetë (10) Ditë të Punës para datës së shpallur në Vërejtjen për Shkyçje përveç rrethanave vijuese në të cilat nuk kërkohet Vërejtja për Shkyçje:
 - (a) Kur vazhdimi i shërbimit krijon kushte të rrezikshme që paraqesin kërcënim për jetën, shëndetin ose sigurinë e cilitdo person fizik të Rrjetit të Shërbimeve të Ujit; ose
 - (b) Kur Konsumatori vullnetarisht kërkon që të ndërpriten Shërbimet e Ujit.

- 7.4 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza së pari duhet të tentojë të shtyjë Konsumatorin të bie në pajtim me kushtet e furnizimit ose të paguajë Faturat e veta para inicimit të Shkyçjes.
- 7.5 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujëra të Zeza, në Regjistrin e Konsumatorëve do të identifikojë të gjithë Personat e Cenueshëm për të cilët Shkyçja krijon rrezik për jetën ose shëndetin e tyre dhe të gjithë Personat të cilëve Shkyçja mund t'u paraqet rrezikun e njëjtë, siç janë objektet publike medicinale.
- 7.6 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të Shkyçë ose të refuzojë të rikyç Shërbimet e Ujit në cilatdo objekte në rastet kur qoftë Konsumatori ose banuesi ka vërtetimin nga mjeku i çertifikuar se lëngon nga ndonjë sëmundje serioze ose ka gjendjen shëndetësore e cila do të përkeqësohet rëndë në mungesë të Shërbimeve të Ujit edhe në qoftë se Konsumatori i tillë nuk është regjistruar si Person i Cenueshëm në Regjistrin e Konsumatorëve.
- 7.7 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të kërkojë pagesa nga Konsumatorët për të mbuluar shpenzimet për dërgesën e vërejtjeve, Shkyçjeve, rikyçeve dhe inspektimeve në shumën e caktuar ose të aprovuar nga Rregullatori.

Neni 8: Hetimi i bërë para se të zbatohet Shkyçja

- 8.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të kërcënohet me Shkyçje ose të Shkyçë konsumatorin i cili e informon Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza se ai i konteston arsyet për Shkyçje.
- 8.2 Kur Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza informohet lidhur me kontestimin nga ana e Konsumatorit ose aplikuesit, qoftë ose mos qoftë Shkyçja e pezulluar, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të:
- (a) Hetojë kontestimin brenda një (1) muaji;
 - (b) Raportoje tek Konsumatori rezultatet e hetimit brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas përfundimit;
 - (c) Bëjë përpjekje të zgjidhë kontestin brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës;
 - (d) Mbajë shënime me shkrim.

Neni 9: Ekzekutimi i Shkyçjes

- 9.1 Të gjitha Shkyçjet do të ekzekutohen nga së paku dy (2) punëtorë të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujëra të Zeza.
- 9.2 Shkyçja do të ndodhë gjatë orarit të rregullt të punës së Ofruesit të Shërbimeve të Ujit

dhe Ujërave të Zeza por nuk do të ndodhë një ditë më parë ose në ditën kur zyra e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk është e hapur për punë me palë ose në cilëndo Ditë të Punës që nuk punohet.

- 9.3 Në rastin kur Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza pengohet fizikisht të ketë qasje në objektet ku duhet të bëhet Shkyçja në mënyrë të ligjshme, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të kërkojë mbështetjen e policisë për të ekzekutuar atë Shkyçje.

PJESA III: PROCEDURAT E SHKYÇJES

Kapitulli 1: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit

Neni 10: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit

Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të kërkojë nga Konsumatori të ofrojë njoftimin e arsyeve për qëllimin e ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit në pajtim me procedurat në vijim:

- (a) Periudha njoftuese e kërkuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të tejkalojë pesë (5) Ditë të Punës; dhe
- (b) Deri në skadimin e periudhës njoftuese ose deri te kryerja të Shkyçjes, cilado që ndodhë më herët, Konsumatori do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet e shkaktuara për dhe/ose lidhur me Shërbimet e Ujit.

Neni 11: Ndërprerja Vullnetare e Shërbimeve të Ujit në Objektivin Tjetër

Kur Konsumatori kërkon Shkyçjen në objektet që janë pronë e Konsumatorit por të banuara nga ndonjë Person tjetër, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të procedojë, përveç nëse:

- (a) Banori jep pëlqimin me shkrim për Shkyçje; dhe
- (b) Vërejtja për Shkyçje dorëzohet sipas Kapitulli 5: Shkyçjet që Kërkojnë Njoftimin për Shkyçje .

Kapitulli 2: Shkyçja për shkak të Rreziqeve Shëndetësore dhe të Sigurisë

Neni 12: Shkyçja për shkak të Rreziqeve Shëndetësore dhe të Sigurisë

Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të Shkyçë Shërbimet e Ujit aty ku vazhdimi i shërbimit drejtpërdrejt shkakton rrezik për jetën ose shëndetin e cilitdo person fizik ose për të punësuarit e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, ose për cilëndo palë të tretë.

Neni 13: Procedurat për Shkyçje për Shkaqe të Shëndetit ose të Sigurisë

- 13.1 Pas identifikimit të rreziqeve për shëndetin ose të sigurinë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të bëjë përpjekje të njoftojë Konsumatorët e prekur para se të zbatojë Shkyçjen por në asnjë rast nuk do të vonojë Shkyçjen në pritje të atij njoftimi.
- 13.2 Sa më parë që të largohet rreziku për shëndet ose i sigurisë, Ofruesi i Shërbimit të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të rikyç Konsumatorët pa kurrfarë shpenzimesh dhe mund të mbulojë shpenzimet nga ata Konsumatorë, nëse ka ndonjë, që është përgjegjës për krijimin e situatës së rrezikshme për shëndet dhe siguri por jo edhe prej cilësdo pale të tretë.

Kapitulli 3: Shkyçja për Shkak të Rrjedhjes në Objektet e Konsumatorit

Neni 14: Rrjedhje të Dukshme, të Jashtme në Objektet e Konsumatorit

- 14.1 Derdhja e ujit nga rrjedhjet e dukshme, të jashtme në Objektet e Konsumatorit nuk lejohet për shkak të sasisë së pakët dhe shpenzimeve për trajtimin e ujit, dhe rrjedhjet e kanalizimit nuk lejohen për arsye të shëndetit publik.
- 14.2 Pas njoftimit nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza qoftë për rrjedhje të ujit ose të kanalizimit të cilat janë të dukshme, Konsumatori duhet të riparojë rrjedhjen brenda pesë (5) ditëve, ose të lidhë kontratë me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për riparimin me pagesë.
- 14.3 Nëse Konsumatori dështon të riparojë cilëndo rrjedhje të ujit ose kanalizimit brenda afatit të caktuar në nën-nenin 14.2, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të Shkyçë Shërbimet e Ujit.
- 14.4 Konsumatori mund të kërkojë Rikyçjen në çdo kohë tek Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza pasi të këtë demonstruar se rrjedhja është riparuar në cilin rast Rikyçja nuk mund të refuzohet në asnjë bazë përveç nëse ka mungesë të pagesës së ndonjë Fature që ka mbetur e papaguar dhe duhet të përfundohet sa më parë që është e mundur por jo më vonë se dy (2) Ditë të Punës nga data e marrjes së kërkesës për Rikyçje.

Neni 15: Procedurat e Shkyçjes për Rrjedhjet në Objektet e Konsumatorit

- 15.1 Nëse është e nevojshme, kurdo që të zbulohet rrjedhja në ndonjë objekt të Konsumatorit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të konsultojë Komunën ku janë të vendosura ato objekte për të përcaktuar kush është Konsumatori ose pronari në librat e kadastrit komunal.
- 15.2 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të dorëzojë Konsumatorit, Pronarit ose Banuesit Vërejtjen për Rrjedhje, duke i ofruar një prej zgjidhjeve vijuese:

- (a) Konsumatori riparon rrjedhjen brenda pesë (5) Ditëve të Punës nuk do të ndërmerret asnjë veprim më tutje; ose
 - (b) Konsumatori kërkon nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të riparojë rrjedhjen brenda pesë (5) Ditëve të Punës me një pagesë korrekte për atë shërbim dhe nuk do të ndërmerret asnjë veprim më tutje.
- 15.3 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të kërkojë pagesën në avans për shpenzimet që lidhen me riparimin e rrjedhjes pas kërkesës së Konsumatorit për të riparuar atë rrjedhje të dorëzuar në bazë të vërejtjes sipas nën-nenit 15.2, në shumën e përcaktuar në Rregullën e Tarifave të Shërbimit të aprovuar nga Rregullatori.
- 15.4 Nëse Konsumatori nuk e riparon, ose nuk kërkon të parapaguajë për riparimin e rrjedhjes nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga data kur është dorëzuar vërejtja sipas nën-nenit 15.2, Konsumatori do të jetë i detyruar të paguajë gjobën sipas Rregullit të lëshuar nga Rregullatori.
- 15.5 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të dërgojë tek Konsumatori vërejtjen e dytë me shkrim duke e informuar Konsumatorin se nëse rrjedhja akoma nuk është riparuar në pesë (5) Ditët e ardhshme të Punës ose nëse gjoba nuk është paguar brenda periudhës së dytë të pesë (5) Ditëve të Punës, Konsumatori do jetë subjekt për Shkyçje pa asnjë vërejtje të mëtejme.
- 15.6 Konsumatori do të ngelë i Shkyçur përderisa:
- (a) Të paguhet gjoba e paraqitur në nën-nenin 15.5 të lartshënuar;
 - (b) Konsumatori ose ka riparuar rrjedhjen ose ka pranuar të paguajë taksën e ngarkuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për riparimin e atyre rrjedhjeve nga ky i fundit; dhe
 - (c) Konsumatori i ka paguar Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza Taksën për Rikyçje në shumë të llogaritur dhe të ngarkuar sipas Rregullit mbi Tarifat për Shërbime të lëshuara nga Rregullatori.
- 15.7 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të riparojë cilëndo rrjedhje të raportuar nga cilido Konsumator i cili ka kërkuar që ai riparim të kryhet brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës duke siguruar që Konsumatori në avans ka paguar shpenzimet për atë riparim sipas nën-nenit 15.3.
- 15.8 Nëse Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dështon që të riparojë rrjedhjet brenda afatit të caktuar të paraparë sipas nën-nenit 15.7 më lartë, në shpenzime të Konsumatorit i cili ka parapaguar për ato riparime, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të jetë i obliguar të bëjë riparimet pa kurrfarë kompensimi.

- 15.9 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të rikyç cilindo Konsumator brenda dy (2) Ditëve të Punës duke u siguruar se është bërë pagesa për taksën për Rikyçje e caktuar për t'u paguar në pajtim me nën-nenin 15.6 (c) më lartë.

Kapitulli 4: Objektet e Braktisura

Neni 16: Shkyçja për Shkak të Braktisjes

- 16.1 Kur Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza identifikon se Kyçja e Shërbimit nuk është më në shfrytëzim për shkak të mungesës së banimit të njerëzve ose dëmtimit të dukshëm të strukturës që bën të pamundur banimin e sigurt të njerëzve, ai do të vendosë Njoftimin për Shkyçje sipas Neni 17.
- 16.2 Nëse askush nuk lajmërohet gjatë periudhës së Njoftimit për Shkyçje, atëherë do të procedohet me Shkyçje.
- 16.3 Nëse bëhet ndonjë vërejtje, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të bëjë hetimin sipas Neni 8 dhe të procedojë varësisht prej rezultateve të hetimit..

Kapitulli 5: Shkyçjet që Kërkojnë Njoftimin për Shkyçje

Neni 17: Njoftimi për Shkyçje

Nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të kërkohet që Konsumatorit t'ia ofrojë me shkrim Njoftimin për Shkyçje duke e lajmëruar për qëllimet e veta për të bërë Shkyçjen, për jo më pak se dhjetë (10) Ditë të Punës para datës kur mendohet të fillojë Shkyçja, në rastet kur arsyeja për Shkyçje është:

- (a) Dështimi për paguar ndonjë Faturë;
- (b) Refuzimi i qasjes në objektet e Konsumatorit për arsye të arsyeshme të lidhura me ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që është kërkuar në çfarëdo baze të pranueshme me Rregullën për Kartën e Konsumatorëve të lëshuar nga Rregullatori;
- (c) Mashtrimi ose shtrembërimi material nga ana e Konsumatorit për cilindo fakt relevant për të lidhë Kontratën e Shërbimit të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe/ose për krijimin e Kyçjes në Rrjetin e Ujit;
- (d) Dështimi nga ana e Konsumatorit për t'iu përmbajtur kushteve të Marrëveshjes për Pagesë të lidhur me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për rregullimin e Borxheve të Vjetra; dhe/ose
- (e) Dështimi i Konsumatorit që të sigurojë Depozitin Garantues sa herë që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ta ketë të drejtën për ta kërkuar atë Depozit Garantues në pajtueshmëri me secilën prej Rregullave që nxjerrën nga

Rregullatori në lidhje me këtë çështje.

Neni 18: Përmbajtja e Njoftimit për Shkyçje

- 18.1 Njoftimi për Shkyçje nga Ofruesi Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të përmbajë së paku informatat si në vijim:
- (a) Të deklarojë shumën të ndarë sipas pozicioneve të cilën e Konsumatori ka borxh dhe periudhën për të cilën janë ofruar Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza;
 - (b) Të japi adresën e zyrës ku duhet të bëhet pagesa për Faturat e papaguara dhe orarin kur ajo zyre është e hapur për punë;
 - (c) Ofrojë informatat lidhur me procedurat të cilat Konsumatori duhet ti ndjek për të kontestuar validitetin e cilësdo Faturë të paguar;
 - (d) Të deklarojë cilat veprime duhet ti ndërmerr Konsumatori për të parandaluar zbatimin e Shkyçjes së inicuar;
 - (e) Të deklarojë kur do të ekzekutohet Shkyçja; dhe
 - (f) Nëse zbatohet Shkyçja, kushtet dhe procedurat të cilat Konsumatori duhet ti ndjek për të kërkuar rikyçje.
- 18.2 Shuma në Llogarinë e Papaguar e deklaruar në Njoftimin për Shkyçje nuk do të përfshijë:
- (a) Shumat për shërbimet tjera përveç atyre të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;
 - (b) Shumat që janë në borxh nga llogaritë tjera, përveç nëse ka ndodhë transferi i bilancit të llogarisë;
 - (c) Shumat që janë në borxh nga Faturat e vlerësuar. Shuma që i ka kaluar afati i pagesës mund të përfshijë Faturat e vlerësuar vetëm nëse Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ka bërë përpjekje për alternativa të mundshme për të pasë qasje ose për të lexuar ujëmatësin e blerë nga Konsumatori; ose
 - (d) Shërbimet e ofruara në emër ose emra të personave të ndryshëm nga Konsumatori, përveç nëse Ofruesi i Shërbimeve ka përcaktuar se Konsumatori është i obliguar sipas ligjit të paguajë shumën e cila ka ngelë e paguar.

Neni 19: Procedurat e Njoftimit për Shkyçje për Prona të Dhëna ose të Marrura me Qira

- 19.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të Shkyçë objektin e banimit të dhënë apo të marrë me qira në kërkesë të qiradhënësit, zotëruesit,

ose agjentit (“pronarit”) ose për arsye se Pronari (si Konsumator i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza) ka dështuar të paguajë Faturën që ka ngelë e papaguar, përveç nëse plotësohen kushtet si në vijim:

- (a) Qiramarrësi pajtohet me shkrim për Shkyçje;
 - (b) Pronari nënshkruan deklaratën e noterizuar se objektet që do të preken nga Shkyçja janë apo do të jenë të zbrazëta;
 - (c) Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza me anë të inspektimeve vetanake përcakton se objektet që do të Shkyçjen janë të zbrazëta; ose
 - (d) Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i dorëzon qiramarrësit Njoftimin për Shkyçje sipas kushteve të Nenit 17 dhe Neni 18.
- 19.2 Në rastin e ndërtesave me shumë banesa, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të dorëzuar personalisht Njoftimin për Shkyçje te së paku një banues i moshës së rritur për secilën banesë.
- 19.3 Sa i përket rasteve ku ndërtesat me shumë banesa kanë një ujëmatës, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza gjithashtu duhet të vendosë Njoftimin për Shkyçje në ose afër hyrjeve të përbashkëta të ndërtesës ose ndërtesave të prekura.
- 19.4 Në secilin rast të Shkyçjeve për objektet e dhëna ose të marrura me qira, përveç fakteve të zbuluara që aplikohen, Njoftimi për Shkyçje duhet të informojë qiramarrësin se si mund të vazhdohen shërbimet qoftë duke i ofruar qiramarrësit mundësinë për të marrë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza në emër të qiramarrësit ose kurdo që qiramarrësi të ketë pranuar me shkrim përgjegjësinë e vet për pagesë të mëtejme të Faturave të atyre objekteve të dhëna ose të marrura me qira.
- 19.5 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të kërkojë nga qiramarrësi të paguajë për cilatdo ngarkesa që janë shkaktuar nga pronari ose të kërkojë depozit ose pagesë në avans në bazë të historisë së pagesës së pronarit për të qenë në gjendje të sigurojë në emër të vet furnizimin me Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza sipas të drejtave që janë dhënë nën nenin 19.4.
- 19.6 Dispozitat e këtij Neni gjithashtu janë të aplikueshme nëse komuna kërkon që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të Shkyçë shërbimet në ndërtesat ku komuna përkohësisht ka vendosur Kontratën për Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza në emër të vet në emër të cilitdo banues të atyre objekteve banuese.
- 19.7 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të kërkojë nga qiramarrësi të paguajë çfarëdo ngarkesa të shkaktuara nga pronari ose të kërkojë depozit ose pagesë në avans të bazuar në historinë e llogarisë së pronarit. Dispozitat e këtij paragrafi gjithashtu janë të aplikueshme nëse komuna kërkon që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të ndërpresë shërbimet për banesa në ndërtesa

ku komuna përkohësisht ka vendosur shërbime emrin e vet në interes të banuesit.

Neni 20: Kompensimi

Në rast se Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dështon ti përmbushë procedurat e Shkyçjes të imponuara me këtë Rregull, atëherë:

- (a) Konsumatori i dëmtuar do të ketë të drejtë të kërkojë kompensim nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për dëmet e shkaktuara si rezultat i kësaj;
- (b) Kompensimi i përshkruar nën (a) të kësaj pjese, nëse ekziston, do të përcaktohet nga Rregullatori sipas udhëzimeve të cilat Rregullatori do ti caktojë dhe duke marrë parasysh edhe natyrën e kundërvajtjes; dhe
- (c) Konsumatori dhe Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza secili do të kenë të drejtë për të kërkuar ndihmë ligjore lidhur me atë vendim.

PJESA IV: SHKYÇJET KOLEKTIVE

Neni 21: Rrethanat për Shkyçje Kolektive

21.1 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të zbatojnë Shkyçjet Kolektive vetëm në ndonjërin prej rrethanave në vijim:

- (a) Kur grupi i Konsumatorëve që Nuk Paguajnë e plotëson definicionin e “Grupit të Kualifikuar”; ose
- (b) Kur Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ka qenë i Penguar Fizikisht të lexojë ujëmatësit ose të zhvillojë aktivitetet e mirëmbajtjes brenda zonës së definuar; ose
- (c) Kur përbrenda rajonit të veçantë gjeografik të aprovuar nga Rregullatori, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ka identifikuar një strukturë të Kycjeve të Paligjshme dhe/ose Rikycjeve që janë në masë të konsiderueshme dhe që në mënyrë substanciale vështirësojnë mundësinë e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të menaxhuar me Rrjetin e Ujit.

21.2 Shkyçjet Kolektive janë të lejueshme vetëm kur Shkyçjet individuale të secilit Konsumator që Nuk Pagan nuk janë teknikisht të realizueshme dhe duhet të zgjasin vetëm për një periudhë minimale të caktuar që nevojitet për ti kthyer Konsumatorët që Nuk Paguajnë në Konsumatorë në Pozitë të Mirë.

21.3 Dispozitat për mbrojtjen e Konsumatorëve në Pozitë të Mirë dhe të publikut që janë prekur për shkak të Shkyçjeve Kolektive do të bëhen deri në atë masë që është

teknikisht e mundshme, që përcaktohet nga Rregullatori.

Neni 22: Leja nga Rregullatori për Shkyçje Kolektive

- 22.1 Asnjë Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të zbatojë procedurat e Shkyçjes Kolektive në mungesë të autorizimit të shprehur me shkrim nga Rregullatori për të bërë një gjë të tillë, që do të vlerësohet prej rastit në rast.
- 22.2 Aplikacioni i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që i dërgohet Rregullatorit për të aplikuar procedurat e Shkyçjes Kolektive që kanë të bëjnë me Grupin e Kualifikuar do të përmbajë, në mes tjerash, informatat si në vijim:
- (a) Pikën e kyçjes për shërbime të ujit në të cilën do të kryhet Shkyçja Kolektive;
 - (b) Arsyen për Shkyçje Kolektive të mbështetur sipas Neni 21;
 - (c) Numrin dhe përqindjen e Konsumatorëve që Nuk Paguajnë brenda Grupit të Kualifikuar;
 - (d) Kopjet e Faturave dhe njoftimeve për pagesë të vonshme si evidencë të mospagesës ose, nëse përcaktohet nga Rregullatori, një ekstrakt i marrë nga gjendja e llogarisë aktuale të Konsumatorëve që Nuk Paguajnë.
- 22.3 Në parashtrimin e kërkesës drejtuar Rregullatorit për të autorizuar procedurën për Shkyçjen Kolektive, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të vërtetojë në nivel të kënaqshëm tek Rregullatori se:
- (a) Ka bërë raportin te policia vendore duke shpallur datën dhe orën kur mendohet të fillohet me Shkyçje Kolektive dhe zonën gjeografike e cila do të preket;
 - (b) Ka bërë dy Shpallje Publike të njëpasnjëshme për Shkyçjen Kolektive të inicuar duke theksuar në vija të trasha për Konsumatorët se si mund ti shmangen asaj me së paku me një njoftim paraprak në periudhë prej tri (3) dhe pesë (5) Ditëve të Punës para Shkyçjes Kolektive;
 - (c) Në Shpalljet Publike ka përfshirë të drejtat e të gjithë Konsumatorëve në Pozitë të Mirë të kërkojnë kompensim nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të lejuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë.
 - (d) Ka njoftuar me shkrim Komunën ku Shkyçja Kolektive do të ndodhë dhe përfaqësuesit regional të caktuar të Shtyllës së II të UNMIK-ut dhe AMK-së për iniciimin e kësaj Shkyçjes Kolektive.

Neni 23: Ekzekutimi i Shkyçjes Kolektive

- 23.1 Periudha fillestare e kohëzgjatjes së Shkyçjes Kolektive nuk guxon të kalojë dyzetetetë (48) orë.
- 23.2 Pas përfundimit të periudhës fillestare të Shkyçjeve Kolektive, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të rivendosë Shërbimet e Ujit për një periudhë të pandërprerë për jo më pak se dyzetetetë (48) orë.
- 23.3 Nëse, me përfundimin e periudhës së parë të rikyçjes, arsyet për Shkyçje Kolektive mbesin ende, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të parashtrijë kërkesën me shkrim tek Rregullatori për të aprovuar zbatimin e Shkyçjes për kohëzgjatje të pacaktuar.
- 23.4 Kërkesat për aprovim të Shkyçjeve Kolektive për një periudhë me kohëzgjatje të pacaktuar duhet të ndjekin procedurat e paraqitura në Neni 22, dhe gjithashtu duhet të përfshijnë masat e kompensimit të cilat Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i propozojnë për t'i paguar Konsumatorët në Pozitë të Mirë si dhe çfarëdo masa tjera për të zbutur ndikimin e pafavorshëm të atyre Shkyçjeve Kolektive kur të kërkojnë për periudhë me kohëzgjatje të pacaktuar.
- 23.5 Nëse, në çfarëdo kohe gjatë Shkyçjes Kolektive, nuk arsyet për Shkyçje Kolektive nuk janë të plotësuara, Ofruesi i Shërbimeve menjëherë do të ndërpresë Shkyçjen Kolektive, të rivendosë Shërbimet e Ujit, dhe do të informojë Rregullatorin për këtë fakt sa më parë që është e volitshme por në asnjë rast më shumë se njëzetetetë (24) orë nga rifillimi i menduar i furnizimit të Shërbimeve të Ujit.
- 23.6 Me përfundimin e procedurës së Shkyçjeve Kolektive të gjithë Konsumatorët të cilët janë anëtarë të Grupit të Kualifikuar më parë dhe të cilët nuk ngelin në Pozitë të Mirë me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të mbesin objekt për procedurat e Shkyçjeve individuale.

Neni 24: Pagesa e Rikyçjes për Shkyçje Kolektive

Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të kërkojë Pagesën për rikyçje sipas Neni 34, për të mbuluar shpenzimet aktuale të shkaktuara dhe të aprovuara paraprakisht nga Rregullatori..

Neni 25: Kompensimi për Dëmet e shkaktuara nga Shkyçja Kolektive

Në rast se Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dështon të zbatojë procedurat e paraqitura në këtë Kapitull, atëherë:

- (a) Secili Konsumator brenda Grupit të Kualifikuar do të ketë të drejtë të kompensohet për Dëmet e shkaktuara si rezultat i Shkyçjes Kolektive, në shumë e cila nuk do të tejkalojë mesataren e shumës së Faturës së Ujit të Konsumatorit gjatë periudhës

paraprake prej gjashtë (6) muajve ose periudhës më të vogël për të cilën ekziston historiyati i pagesës;

- (b) Vlera e Dëmeve do të caktohet nga Rregullatori; dhe
- (c) Konsumatori dhe Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza secili prej tyre do të ketë të drejtë për mbështetje ligjore lidhur me cilindo vendim të tillë.

Neni 26: Kompensimi për Konsumatorët në Pozitë të Mirë

- 26.1 Në rast se Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në kuadër të Shkycjes Kolektive, duke zbatuar procedurat e paraqitura në këtë Rregull, i Shkyc Konsumatorët në Pozitë të Mirë, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të kompensojë ata Konsumatorë duke u ofruar kredi në Faturat e ardhshme për Shërbimet e Ujit në vlerë prej dy herë nga mesatarja e sasisë së ujit të cilin këta Konsumatorë do të kishin shpenzuar nëse nuk do të ishin prekur nga Shkycja Kolektive.
- 26.2 Për qëllimet e paraqitura në nën-nenin 26.1, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të konsiderojë se uji të cilin e kanë shfrytëzuar Konsumatorët në Pozitë të Mirë nëse nuk do të ishin prekur nga Shkycjet Kolektive do të jetë e barabartë me sasinë mesatare të ujit të konsumuar nga këta Konsumatorë në tri (3) muajt e fundit para muajit kur kanë filluar Shkycjet Kolektive përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe nga Rregullatori me dhënien e autorizimit për ato Shkycje Kolektive.

PJESA V: RIKYÇJET DHE DEPOZITET PËR GARANCI

Kapitulli 6: Rikycjet e Shërbimeve të Ujit

Neni 27: Rikycja nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit

- 27.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të rikyc Shërbimet e Ujit të Konsumatorit jo më vonë se dy (2) Ditë të Punës pasi që ai Konsumator të ketë paguar në tërësi shumën që ka borxh në Faturën e tij ose të këtë hyrë në Marrëveshje të Pagesës ose të përmbushë kushtet e saj.
- 27.2. Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të pajtohet që të rikyc Konsumatorin në Shërbimet e Ujit para shlyerjes së borxhit në tërësi të Faturës së papaguar nga Konsumatori me kusht që të jetë arritur Marrëveshja për Pagesë në pajtim me dispozitat e këtij Rregulli.

Neni 28: Refuzimi për të Rikycur

- 28.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të vendosë që të refuzojë furnizimin e Konsumatorit që përsëritë mospagesën a Faturave për Shërbime të Ujit dhe Ujëra të Zeza përveç nëse ai Konsumator do të kryej Depozitin Garantues sipas dispozitave të këtij Rregulli.

- 28.2. Nën rrethana të tilla, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të largojë Pajisjet e Shërbimit të Ujit të Konsumatorit sipas Neni 30.
- 28.3. Në rast se objektet të cilat më parë janë furnizuar nga ato kycje të shërbimeve kërkojnë rikycje, qoftë nga i njëjti ose ndonjë banues tjetër, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të trajtojë atë rikycje të shërbimit në ato objekte si kycje të re, një javë pasi që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të ketë njoftuar ose të ketë bërë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar Konsumatorin për qëllimet e tij sipas këtij neni.

Neni 29: Rikycjet e Paligjshme

- 28.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të Shkyc Konsumatorin menjëherë dhe pa Njoftim për Shkycje kur të identifikojë rikycjen e paligjshme.
- 28.2 Konsumatori i cili pas Shkycjes rikycet në mënyrë të paligjshme do t'iu nënshtrohet dënimeve që caktohen nga Rregullatori, dhe ato dënime do të shtohen në Faturën e Konsumatorit nga ana e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.

Neni 30: Konfiskimi i Pajisjes për Shërbime të Ujit

- 30.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ka të drejtë të konfiskojë dhe të largojë nga objektet e Konsumatorit të gjitha Pajisjet për Shërbime të Ujit, duke përfshirë të gjitha pajisjet matëse të vendosura në objektet e Konsumatorit në rast se Konsumatori, pas Shkycjes, vazhdimisht bën Rikycje të Paligjshme përkundër vënies së dënimeve të përcaktuara nën Neni 29.
- 30.2 Para se të largojë fizikisht të gjitha Pajisjet për Shërbimet e Ujit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të bëjë një regjistrim të gjitha mjeteve themelore të cilat janë larguar, do të shënojë gjendjen e tyre dhe çfarëdo dëmtime që janë shkaktuar nga Konsumatori në ato mjete themelore që nuk kanë rrjedhë si pasojë e shfrytëzimit të kujdesshëm ose normal të aseteve të cilat do të mbahen për një (1) vit ose derisa të rikycet Shërbimi i Ujit, cilado që ndodhë më herët.
- 30.3 Para largimit të cilësdo Pajisje për Shërbime të Ujit nga objektet e Konsumatorit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza gjithashtu do të verifikojë nëse Kycja e Shërbimeve është e mbyllur në mënyrë që të mos ketë rrjedhje e as rrezik nga kontaminimi në Rrjetin e Ujit.
- 30.4 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Konsumatori kompensim të plotë për cilatdo dëme të shkaktuara në Pajisjet e Shërbimeve të Ujit nga ana e Konsumatorit siç është e përshkruar dhe vlerësuar në regjistrimin e mbajtur sipas nën-nenit të mësipërm 30.3, para se të procedohet me rikycjen e Konsumatorit në Rrjetin e Ujit..

Kapitulli 7: Depoziti Garantues

Neni 31: Depoziti Garantues

- 31.1 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të kërkojë nga Konsumatori i cili më parë ka qenë i nënshtuar Shkyçjes të paguajë Depozitin për Garanci që nuk tejkalon dyfishin e mesatares së shumës totale të pagueshme që paraqitet në Faturën mujore të Konsumatorit të lëshuar për periudhën e dymbëdhjetë (12) muajve paraprak, duke mos përfshi tatimin mbi vlerën e shtuar dhe çfarëdo tatime tjera, obligimet zyrtare dhe taksat e ngarkuara në Faturë nga cilido autoritet publik.
- 31.2 Depoziti Garantues nuk do të lirojë Konsumatorin nga obligimet e tij për të paguar Faturat e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza kur të jenë të pagueshme.
- 31.3 Në rastin kur Konsumatori ka bërë Depozitin Garantues dhe kur ai Konsumator rrjedhimisht është Shkyçur nga Shërbimi i Ujit për shkak të mos pagesës së Faturave, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të ketë të drejtë të përdorë Depozitin Garantues në emër të pagesës për atë Llogari të Papaguar, përveç nëse Konsumatori, jo më vonë se katër (4) Ditë të Punës pasi që është Shkyçur parashtroon kërkesën për rikyçje të Shërbimit të Ujit dhe të paguan Llogarinë e Papaguar. Poashtu mund të kërkojë nga Konsumatori që kohë pas kohe të balancojë origjinalin e Depozitit Garantues deri në shumën maksimale të përcaktuar me nën-nenin 31.1.
- 31.4 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përdorë Depozitin Garantues për pagesën e Faturave pasuese derisa ai depozit të mos tregojë bilancin zero që nga muaji i parë për dymbëdhjetë (12) muaj të pandërprerë ku Konsumatori ka paguar të gjitha Faturat, duke përfshirë cilatdo shuma kumulative të pagueshme sipas Marrëveshjes për Pagesë, brenda afateve të pagesës.

PJESA VI: MARRËVESHJET PËR PAGESË

Neni 32: Marrëveshjet për Pagesë

- 32.1 Kur Konsumatori Shtëpiak nuk është në gjendje ti paguajë Faturën Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, Shërbimi i Ujit për Konsumatorin do të vazhdohet me kusht që Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Konsumatori të pajtohen për Marrëveshjen e Pagesës ku Konsumatori:
- (a) paguan Faturën dhe secilën Llogari të Papaguar në këste të arsyeshme; dhe
 - (b) paguan Faturat e ardhshme në afat të pagesës që është shtypur në Faturë ose sipas Marrëveshjes për Pagesë.
- 32.2 Marrëveshjet për Pagesë mund të përcaktojnë:

- (a) Nëse Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do ti lejojë Konsumatorit të paguajë Faturat e papaguara dhe Llogaritë e Papaguara në këste për një periudhë kohore që nuk tejkalon dymbëdhjetë (12) muaj; dhe
 - (b) Që gjatë periudhës së pagesës në këste duhet gjithnjë të kërkohet nga Konsumatori të paguajë Faturat e vijuese.
- 32.3 Me rastin e vendosjes se a të lidhet apo jo Marrëveshja për Pagesë dhe përcaktimit të afateve dhe kushteve që ti propozohen Konsumatorit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të merr parasysh:
- (a) Shumën e Faturës së Llogarisë së Papaguar;
 - (b) Shumën e vlerësuar të Faturave mujore të ardhshme të Konsumatorit;
 - (c) Historia e pagesës së Konsumatorit lidhur me Borxhet e Vjetra;
 - (d) Arsyet pse një Borxh i Vjetër nuk është paguar dhe nëse ato arsye ka gjasa të jenë apo të mos jenë gjatë periudhës sa është në fuqi Marrëveshja për Pagesë, sa herë që një vlerësim i tillë është praktik ose i mundshëm; dhe
 - (e) Në rastin e Konsumatorit të Varfër, mundësia e tij për të paguar e konfirmuar nga autoritetet kompetente të sigurisë sociale, sa herë që informatat e tilla janë në dispozicion.
- 32.4 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Konsumatori do të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Pagesë me kontratën e cila në mënyrë substanciale do të ketë përmbajtjen dhe formatin e kontratës model të bashkangjitur si shtojcë në këtë Rregull.
- 32.5 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatisë dhe t'ia lëshojë një kopje të draftit të kontratës Konsumatorit që i referohet në nën-nenin e lartpërmendur 32.4 jo më vonë se pesë (5) Ditë të Punës pas datës kur Konsumatori është ofruar për të lidhur Marrëveshjen për Pagesë, për ti dhënë Konsumatorit mundësinë për shqyrtim dhe verifikim të kushteve të asaj Marrëveshje për Pagesë.
- 32.6 Drafti i kontratës me anë të së cilës Marrëveshja për Pagesë duhet të dakordohet me Konsumatorët ose çfarëdo komunikate që i dërgohet në të njëjtën kohë Konsumatorit për efektin e njëjtë, duhet që në mënyrë specifike të theksojë se:
- (a) Dështimi për të respektuar Marrëveshjen për Pagesë mund të shpie në Shkyçje; dhe
 - (b) Konsumatori ka të drejtë të kontaktojë me Komisionin lokal Këshillues të Konsumatorëve nëse Konsumatori nuk pajtohet me kushtet e draft kontratës përmes së cilës Marrëveshja për Pagesë duhet të miratohet brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës nga data e pranimit të draftit të asaj kontrate.

- 32.7 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të Shkyçë asnjë Konsumator për shkak të dështimit për të përmbushur Marrëveshjen për Pagesë e cila nuk është bërë me shkrim me Konsumatorin sipas kontratës që i referohet nën-neni 32.4.
- 32.8 Nëse Konsumatori dështon të lidhë kontratën me Ofruesin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për një Marrëveshje të Pagesës për pagesën e çfarëdo Faturave të cilat Konsumatori i ka borxh për Shërbimet e ofruara të Ujit dhe Ujërave të Zeza brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës nga data e pranimit të atij drafti të kontratës ose nga cilido vendim i marrur përkitazi me atë nga Komisioni Këshillues i Konsumatorëve, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të konsiderojë se Konsumatori ka refuzuar të hyjë në Marrëveshjen për Pagesë dhe do të ketë të drejtë të Shkyçë atë Konsumator brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me këtë Rregull.

Neni 33: Kontestimet e Besueshme të Faturave

- 37.1 Në rast të Kontestimit të Besueshëm të Faturave, në çfarëdo shume të caktuara për tu paguar në Llogaritë e Papaguara ose në Marrëveshjen e Pagesës ose në Faturat e Tanishme, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza nuk do të ketë të drejtë të Shkyçë Shërbimet e Ujit përderisa nuk përfundojnë hetimet dhe Konsumatori të pajtohet me kushtet e pagesës siç është e përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë.
- 33.2 Secili hetim për Kontestimin e Besueshëm të Faturës duhet të përfshijë:
- (a) Kontrollimin e shënimeve të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të identifikuar datën dhe shumën e Faturave të dërguara tek Konsumatori dhe datën dhe shumën e paguar nga Konsumatori;
 - (b) Kontrollimin e dëftesave të Konsumatorit për pagesa;
 - (c) Përmbledhjen e rezultateve që tregojnë shumën totale të cilën Konsumatori e ka borxh.
- 33.3 Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do t'ia raportojë Konsumatorit rezultatet e hetimit të bërë në pajtim me nën-nenin 33.2 dhe të ruaj shënimet për së paku dy (2) vite pasi që rezultatet e hetimit të jenë raportuar tek Konsumatori.
- 33.4 Kontestimet e Besueshme të Faturave që nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore mund ti referohen Komisionit Këshillues të Konsumatorëve me kërkesë të Konsumatorit sipas procedurave të krijuara për ato komisione.

Neni 34: Pagesat për Njoftimet e Shkyçjes, Shkyçje, dhe Rikycje

- 34.1 Kur Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza i dërgon punëtorët e vet tek

objektet e cilitdo Konsumator me qëllim të dërgimit të Njoftimit për Shkyçje, ose që të Shkyçin atë Konsumator, ose Rikyçin ndonjë Shkyçje, atëherë pagesa mund të shtohet nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Faturën e atij Konsumatori për të mbuluar shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që dërgojnë ata punëtorë tek objektet e Konsumatorit.

- 34.2 Pagesat që referohen në nën-nenin 34.1 do të llogariten dhe të ngarkohen sipas Shtojcës që është në këtë Rregull.

PJESA VII: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT

Kapitulli 8: Zbatimi i Rregullit për Shkyçje

Neni 35: Zbatimi i Rregullit për Shkyçje

- 35.1 Rregullatori do të monitorojë respektimin e procedurave për Shkyçje të përcaktuara me këtë Rregull dhe mund të ndërmarrë veprime të zbatueshme ose vendime për Tarifa të Shërbimit bazuar në nivelin e respektimit nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.
- 35.2 Monitorimi i respektimit do të bëhet në bazë të shënimeve dhe raporteve të përgatitura dhe të mbajtura nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza sipas rregullave të cilat Rregullatori do ti përcaktojë kohë pas kohe.

Kapitulli 9: Shënimet dhe Raportet mbi Shkyçjet

Neni 36: Shënimet dhe Raportet mbi Shkyçjet

- 36.1 Të gjitha shënimet lidhur me Shkyçjet do të mbahen në zyrën kryesore të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe do të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës për t'u kontrolluar nga Rregullatori.
- 36.2 Secili Ofrues i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përgatisë dhe do të dorëzojë raportet tek Rregullatori deri në ditën e 15-të të muajit që pason pas muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor, duke përdorë formatin e caktuar në Shtojcën e këtij Rregulli.

Kapitulli 10: Kundërvajtjet dhe Dënimet

Neni 37: Kundërvajtjet dhe Dënimet

- 37.1 Dështimi për të respektuar cilëndo prej procedurave dhe afateve të caktuara me këtë Rregull do të përbëjë kundërvajtje, dhe Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza që ka dështuar ti respektojë mund ti nënshtrohet gjobitjes sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe

37.2 Mbeturina në Kosovë.

37.2 Gjohat do të vihen sipas procedurës së krijuar nën Rregullin mbi vënien e gjbave dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale siç përcaktohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Kapitulli 11: Ankesat

Neni 38: Ankesat

- 38.1 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza mund të ankohen tek Komisioni për Shqyrtim, i krijuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë, në cilindo vendim konkret të Rregullatorit nën këtë Rregull.
- 38.2 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza gjithashtu mund të ankohen në gjyqet e Kosovës nga shkak i cilitdo vendim të Komisionit për Shqyrtim që është marrë në ndonjë vendim konkret sa i përket zbatimit të procedurave të Shkyqjes të përcaktuara me këtë Rregull sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë në nën-nenin e mësipërm 38.1.


PJESA VIII: TË NDRYSHME


Neni 39: Gjuhët Zyrtare të Rregullit

- 39.1 Kjo Rregull lëshohet dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
- (a) Anglisht;
 - (b) Shqip; dhe
 - (c) Serbisht.
- 39.2 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat kjo Rregull është lëshuar, verzioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

Neni 40: Hyrja në Fuqi

Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë kalendrike pas datës së nënshkrimit dhe lëshimit.


Paulino Brillhante Santos
Drejtor


Afrim Lajçi
Zëvendës Drejtor

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

PAGESAT PËR NJOFTIMET PËR SHKYÇJE, SHKYÇJET, DHE RIKYÇJET

Nr.	Aktiviteti i Ofruesit të Shërbimeve	Shuma për Faturim
1	Përgatitja dhe dorëzimi i Njoftimit për Shkyçje	10 EUR
2	Shkyçja e Shërbimit	25 EUR
3	Rikyçja e Shërbimit	25 EUR
4	Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Sipas normave të publikuara për material dhe punë dore
5	Gjoha për mos riparimin e rrjedhjes në objektin e Konsumatorit	100 EUR

SHTOJCA 2

MODELI I KONTRATËS PËR MARRËVESHJEN E PAGESËS

MODELI I KONTRATËS PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA DHE BORXHEVE VIJUESE NDAJ OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË

[REDACTED]
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza)

[REDACTED]
(Adresa e Ofruesit të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza)

[REDACTED]
(Emri i Komunës)

Nr. i Referencës së Ofruesit të Shërbimeve: [REDACTED]

Nr. Identifikues i Konsumatorit: [REDACTED]

Datë: [REDACTED]

Nr i Llogarisë së Konsumatorit: [REDACTED]

KONTRATË PËR PAGESËN E BORXHEVE TË VJETRA

Kjo kontratë është bërë për të bërë të ditur vlerën dhe për të paguar Borxhin e Vjetër dhe Borxhin Vijues për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza në vlerë ("Kontrata") në [REDACTED], Kosovë, më datë [REDACTED], 200_

NDËRMJET

(1) [REDACTED] Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ("Ofruesi i Shërbimeve") dhe

(2) [REDACTED] me Nr. të ID [REDACTED], dhe adresë kryesore

[REDACTED]

[REDACTED] ("Konsumatori").

Që referohen individualisht si "Palë" dhe kolektivisht si "Palët".

PËRSHKRIMET

Duke marrë parasysh se Konsumatori e ka të njohur:

- (a) ka qenë i kyçur në Rrjetin e Ujit që operohet nga Ofruesi i Shërbimeve, qoftë me kyçje ligjore apo kyçje jo ligjore, dhe nuk e ka shlyer llogarinë e papaguar, dhe
- (b) Konsumatori njeh që ai ose ajo nuk është identifikuar si Konsumatorë i Cenueshëm.

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që Ofruesi i Shërbimeve në mënyrë të kënaqshme ka demonstruar që ka në shënimet e tij informatat vijues:

- (a) emrin dhe adresën e saktë të Konsumatorit; dhe/apo
- (b) historinë e pagesave të konsumatorit në dosjen e tij, duke përfshirë shënimet e orës atëherë kur ka qenë e mundur, dhe

Duke marrë parasysh se Palët pajtohen që kjo Kontratë është lidhë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, Rregullin mbi Faljen dhe Shlyerjen e Borxheve të Vjetra dhe Rregullin mbi Shkyçjen e Shërbimeve të Ujit;

Prandaj, në frymën e asaj që u tha më lartë, Palët me këtë pajtohen si vijon:

1. Përkufizimet:

“Borxhi i Vijues” nënkupton të gjitha borxhet e evidentuara nga Faturat e pakontestuar të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori me apo pas 1 janar 2003, i cili që nuk është paguar krejtësisht ashtu si është definuar në Rregullin për Falje dhe Shlyerje të Borxhit të Kaluar nga Rregullatori;

“Llogaria e Papaguar” nënkupton llogarinë në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve e cila nuk është rregulluar (paguar) nga Konsumatori në frymën e zakonshme të afarizmit, në lidhje me Borxhin e Vjetër dhe atë Vijues, kur Konsumatori ka marrur Faturat me kohë dhe ka pasë një afat të arsyeshëm për ti paguar.

“Fatura” nënkupton dokumentin e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek Konsumatori i cili shënon shërbimet e kryera, mallrat e dorëzuara, Tarifat e Aplikueshme të Shërbimeve, çmimet e tyre apo taksat e aplikueshme, çfarëdo takse apo gjobe zyrtare, dhe shumën totale që ka borxh Konsumatori. Ofruesi i Shërbimeve mundet, sipas vendimit të tij, nëse i kërkohet me ligj apo caktohet nga Rregullatori kohë pas kohe, të përfshijë informata shtesë;

“Borxh i Vjetër” nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorit të evidentuara nga Faturat e pakontestueshme të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetorit 2002, që nuk janë paguar në tërësi siç është përcaktuar në Rregullin e lëshuar nga Rregullatori mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra;

“Konsumator i Cenueshëm” nënkupton:

- çfarëdo Personi që është i certifikuar nga ndonjë mjek se i është i rrezikohet jeta ose shëndeti pa Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza;

- secili Konsumatorë i klasifikuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale në pajtueshmëri me Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/28, Ligji Nr. 2003/15 Mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë, si i varfër dhe skamnor, dhe i këshillohet Ofruesit të Shërbimeve që t'i mundësohet që faturën e tij ta paguajnë autoritetet e mirëqenies sociale;

Të gjitha shprehjet e tjera dhe frazat e përdorura në këtë kontratë me fjalët e shkruara me shkronja të mëdha do të renditen dhe interpretohen në përputhje me definicionet e ofruara në Rregulloren e UNMIK-ut dhe në Rregullin mbi Faljen dhe Zgjedhjen e Borxheve të Vjetra,

2. **Pranimi dhe Saktësia e Faturës:**

- (a) Me këtë Konsumatori pranon se i ka pranuar Faturat, të bashkangjitura në këtë Kontratë, nga Ofruesit të Shërbimit dhe se ato Fatura saktësisht reflektojnë shumën e plotë të Llogarisë së Papaguar që Konsumatori i ka mbetur Ofruesit të Shërbimeve
- (b) Me këtë Konsumatori më tutje pranon se të gjitha borxhet e përfshira me këtë Kontratë janë shkaktuar gjatë periudhës që ka filluar prej datës [REDACTED] të muajit [REDACTED], XXXX dhe ka mbaruar me datën [REDACTED] të muajit [REDACTED], XXXX.
- (c) Pagesa që duhet të bëhet nga Konsumatori siç është përcaktuar në këtë Kontratë duhet të përmbajë pagesën e plotë të gjitha borxheve të Konsumatorit ndaj Ofruesit të Shërbimit.

3. **Afatet e Pagesës:**

- (a) Pagesa e Plotë sa i përket Konsumatorëve të Regjistruar dhe Faturuar: Konsumatori me këtë pranon obligimin e tij që të paguajë Llogarinë e tij të Papaguar ndaj Ofruesit të Shërbimit për shumën totale prej [REDACTED] EUR ashtu siç është paraqitur në Faturën e lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit në vijim të kësaj Kontrate dhe të bashkangjitur me të;
- (b) Nuk do të Paguhet Kamata: Ofruesi i Shërbimeve nuk do të aplikoj kamatë në shumën që duhet të paguhet për të rregulluar Llogarinë e Papaguar.
- (c) Plani i Pagesës: Ofruesi i Shërbimeve me këtë ofron, dhe Konsumatori pranon që të paguaj shumën e plotë të Faturës sipas një Marrëveshje për Pagesë që përbëhet prej pagesës së kësteve mujore të njëjta, në shumë prej [REDACTED] EUR (shkruani shumën me shkronja) për [REDACTED] muaj, duke filluar me me pagesën e parë që duhet të bëhet më date [REDACTED].

4. **Të Tjera**

- (a) Ligji Qeverisës dhe Kontestet: Kjo Kontratë dhe të drejtat dhe obligimet e Palëve që dalin nga kjo do të qeveriset, interpretohet dhe shpjegohet duke u bazuar në ligjet e Kosovës dhe çfarëdo kundërthënie tash e tutje do të jetë çeshtje për zgjedhje në gjyqet e Kosovës.
- (b) Marrëveshja e Plotë: Kjo Kontratë, së bashku me Faturën e bashkangjitur, paraqet marrëveshjen e tërësishme në mes të Palëve në lidhje me pagesën e borxhit, dhe mbizotëron mbi të gjitha marrëveshjet paraprake me gojë ose me shkrimi në mes të Palëve që kanë të bëjnë me këtë Kontratë.
- (c) Bartja: Palët pajtohen që: Ofruesi i Shërbimit nuk do të ketë të drejtë me këtë Kontratë që ti bartë ndonjë apo të gjitha të drejtat dhe interesat e veta çfarëdo

personi tjetër pa pëlqimin e konsumatorit; dhe se Konsumatori me këtë Kontratë *nuk* do të jetë në gjendje që ti barti të drejtat apo obligimet ndonjë personi të tretë pa marrur pëlqimin me shkrim nga Ofruesi i Shërbimit.

- (d) Palët: kjo kontratë është lëshuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbajë nga një kopje.

SI DËSHMI se kjo Kontratë është ekzekutuar në ditën e parë të shkruar më lartë nga:

Për dhe në emër të: _____
(Emri i Ofruesit të Shërbimeve)

Përfaqësuar nga: _____
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: _____

Datë: _____

Për dhe në emër të: _____
(Emri i Konsumatorit)

Përfaqësuar nga: _____
(Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar)

Nënshkrimi: _____

Datë: _____